


KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT

SH. A.



RAPORTI VJETOR I HIDRODRINIT 2017



Mars 2018

1. PËRMBAJTJA

1. Përmbajtja	2
Hyrje.....	3
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.....	4
• Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
o <i>Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2017</i>	4
o <i>Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit</i>	9
o <i>Një pasqyre e të priturve për vitin 2018</i>	11
• Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	11
o <i>Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit</i>	11
o <i>Investimet e bëra gjatë vitit 2017</i>	11
o <i>Dividendët e paguara gjatë vitit 2017</i>	12
• Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv.....	12
o <i>Bordi i Drejtorëve në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë ka këtë përbërje</i>	12
o <i>Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2016</i>	12
o <i>Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2017</i>	13
o <i>Komisioni i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:</i>	14
• Informacione të tjera	15
o <i>Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2017</i>	15
o <i>Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve</i>	15
3. Raporti i Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv.....	16
• Ngjarjet kryesore të vitit 2017	16
• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	19
o <i>Prodhimi i ujit</i>	19
o <i>Kualiteti i ujit</i>	19
o <i>Falja e Borxheve</i>	20
o <i>Çështjet Ligjore</i>	20
• Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet	22
• Progresi me planin e Biznesit	22
• Shpenzimet kapitale.....	23
• Perspektiva për vitin e ardhshëm	23
• Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	25

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës, është pronare e shoqërive aksionare me kapital publik. Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Hidrodrini" SH. A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L- 087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, të datës 14.07.2009 dhe të Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, të datës 30.09.2009. Shoqëria është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike, Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Hidrodrini" Holding SH. A

Numri popullatës që Kompania Rajonale, "HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 185.000 banor, gjegjësisht me 970 Km gjatesi të rrjetit të ujesjellesit ndërsa shërbimet e ujërave të zeza ~ 60,000 banor, gjegjësidht me 160 Km gjatsi të rrjetit të ujerave te zeza. Kapaciteti momental prodhues sillet 25.659.957 m³/Vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofruer profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtoreve i përzgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Stafit menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Raporti Vjetor I KRU " Hidrodrini" Sh. A. - Pejë për vitin 2016 është përpiluar duke u bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitën 28.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike të lëshuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike .

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të NP-së ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarin e zyrtarëve të NP-së, gjithnjë në përputhje me te drejtat dhe përgjegjësit e Bordit.

- **Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes**

- ***Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2017***

- Përkushtim, angazhim më i madhë i punëtorëve në teren.
- Matje korrekte të konsumit.
- Instalim të ujëmatësve në zonat dhe caktimi i zonave DMA.
- Riparim të rrjedhjeve sipërfaqësore.
- Identifikim të rrjedhjeve nëntokësore në kuader të menaxhimit të humbjeve.
- Reduktim të sasisë së ujit në zona të caktuara (presioni).
- Identifikim të shfrytëzuesve të pa autorizuar (vjedhja e ujit).
- Rritje e numrit të konsumatorëve.
- Rritjen e investimeve në zëvendësim e gypave të vjetër.
- Rritja e shkallës së arkëtimit.
- Hartimi i listës me emra të borxhlive dhe procedimi me Përmbarues.
- Vazhdimi i kontratave me PTK, për pagesat e faturave në pikat e tyre.
- Hartimi i listës investuese prioritare për donatorët potencial.
- Ngritja e efikasitetit të stafit.
- Sistemimi i punëtorëve.
- Përforsimi i zbatimit të Ligjit.

Gjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2017 kanë marrë vendime dhe kanë dhënë rekomandime apo sygjerime për zgjidhjen çështjeve të ndryshme të cilat kanë pasur ndikim pozitiv në performancën e Kompanisë, si për :

- Rritjen e arkëtimit të borxheve;
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Zvogëlimin e shpenzimeve;
- Furnizimin me ujë të konsumatorëve 24 h/në ditë;
- Kualitetin dhe sasinë e ujit të prodhuar;
- Harmonizimin e Planit të Biznesit të KRU "Hidrodrini" Sh. A. me Planet Komunale
- Ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e faturimit në m³si dhe
- Reduktimin e lidhjeve të paautorizuara

Gjithashtu, gjatë muajit Mars – 2017 është përgatitur edhe **Qeverisja Korporativee KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2016** dhe e njëjta është dorëzuar si kopje fizike në NjPMNP, në afat ligjor.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2017 ka përcjellë edhe ecurinë e implementimit të Projekteve kapitale, si:

Procedurat e zhvilluara lidhur me Projektin e ndërtimit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza donacionin nga Banka Gjermane dhe Zyra Zvicerane kanë qenë:

- Agjenti tenderues i caktuar nga Banka Gjermane KFW kanë bërë termat e referencës për të cilat Kompania nuk ka pasur vërejtje dhe të njëjtat janë proceduar në fazën e dytë të zgjedhjes së konsulencës.
- Është bërë edhe përzgjedhja e firmave konsulentë për AMC dhe IC. Për IC është përzgjedhur Partneri implementues Dahlem Ber. Ingenieure (Essen) kurse, për AMC është përzgjedhur Partneri implementues SachenWasser (Leipzig).

Po ashtu, Bordi i Drejtorëve ka përcjell edhe implementimin e projekteve tjera siç janë:

- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Pejë, Istog, Klinë, Junik, Strellcë
- Rehabilitimi i rrjetit të ujërave të ndotura me KK-Pejë
- Rehabilitimi i pullazit të objektit në NjO të Deçanit
- Ndërtimi i objektit - aneksi për inkasantë
- Riparimi i stacioneve të klorinimit
- Rehabilitimi i rrethojave të të gjitha burimeve të ujit
- Rasti i Klinës, zgjidhja e problemit me ujë të pijshëm
- Instalimi i ujëmatëseve elektronik

Në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë, ndër të tjera janë shqyrtuar dhe janë aprovuar edhe këto dokumente :

- Raporti Vjetor për vitin 2016
- Raporti Vjetor mbi Kënaqshmerinë e Konsumatorëve 2016
- Pasqyrat Financiare – 2016
- Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare 2016 dhe Letër Menaxhmentin
- Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor 2018-2020
- Raportet Operative dhe Financiare mujore dhe TM
- Raportet mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për TM
- Raportet mbi Kënaqshmerinë e Konsumatorëve për TM
- Vlerësimin e performances së KRU “Hidrodrini” Sh. A.
- Vetëvlerësimin e Bordit të Drejtorëve për vitin 2016.

- Rregulloret e hartuara nga ana e Autoritetit Rregullativ i Shërbimeve të Ujësllësit bashkëpunim me Kompanitë Rajonale të Ujësllësve, si vijon :

Rregullorja nr. 01/2017 për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve,
 Rregullorja nr. 02/2017 për procedurat e lidhjes së konsumatorëve në shërbimet e ujit,
 Rregullorja nr. 03/2017 për procedurat e ndërprerjes së shërbimeve të ujit,
 Rregullorja nr. 04/2017 për procedurat e faturimit për Shërbimet e ujit,
 Rregullorja nr. 05/2017 për matjen e konsumit të ujit.

- Njoftimin lidhur me Raportin Vjetor të Performancës të Ofruesve të Shërbimeve të ujit - 2016 nga ARRU –ja,
- Deklaratën për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2016,
- Kërkesa e menaxhmentit për të filluar procedurat për sigurimin shëndetësor vullnetar të punëtorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë,
- Aplikacionin e tarifave të shërbimit për furnizim me ujë dhe shërbimeve me ujëra të ndotura pranë Autoritetit Rregullativ për shërbimet e ujit për procesin tarifar 2018 - 2020.

Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Raporti Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 është përgatitur sipas detyrimeve që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh. A. gjatë vitit 2017 ka kryer aktivitetet e auditimit sipas Planit Vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2017 , të aprovuar nga Komisioni i Auditimit.

Plani Vjetor është përgatitur sipas Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën kohore 2017-2019.

Gjatë vitit 2017 janë kryer auditimet sipas Planit Vjetor, nuk ka pasur auditime shtesë apo auditime me kërkesë nga Komisioni i Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2017, ka aprovuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018, në mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit.

Nr	Përshkrimi i auditimit	Objektivat e auditimit	Indeksi i rrezikut	Rekomandimet e dala nga auditimet	Personeli i angazhuar në auditim
1.	Mbikqyrja e punës së Komisioneve regjistruese për stoqet, inventarin asetet dhe paratë e gatshme.	Përcjellja e punës së Komisioneve regjistruese .	2.00	2 rekomandime	1
2.	Shërbimi Teknik	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës së Shërbimit Teknik	3.00	4 rekomandime	1
3.	Laboratori	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës në laborator	2.00	2 rekomandime	1
4.	Shërbimi Juridik	Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve mbi punësimet .	2.00	2 rekomandime	1
5.	Auditimi në Shërbimin për	Zbatimi i Rregullores së brendshme mbi pranimin dhe	2.00	2 rekomandime	1

	Konsumator	shqyrtimin e ankesave.			
6.	Auditimi i Rregullores së brendshme mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.	Kontrollimi i zbatueshmërisë së Rregullores së brendshme mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.	3.00	2 rekomandime	1
7.	Plani Vjetor për vitin 2018.	Përgatitja e Planit Vjetor për vitin 2018	1.00		1
8.	Departamenti Financiar.	Deklarimet Tatimore, respektimi i normave dhe afateve kohore të përcaktuara nga ATK-ja.	2.00		1
9.	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2017.	Përcjellja dhe monitorimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dala gjatë vitit 2017.	3.00		1

o **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit**

Vitet	2014	2015	2016	2017	Planifikuar 2017
Prodhimi (m ³)	29.782.872	25.559.988	25.563.723	25.659.957	25.200.000
Faturimi (m ³)	8.682.341	8.774.145	9.006.961	9.266.841	9.960.000
Humbjet (%)	71%	66%	65%	62%	60%
Shpenzimet (Euro)	2.068.872	2.191.685	2.285.876	2.448.283	2.472.000

Vitet	2014	2015	2016	2017	Planifikuar 2017
Faturimi (€)	3.369.691	3.443.182	3.537.082	3.644.856	3.720.000
Inkasimet (€)	2.239.383	2.507.335	2.764.127	2.912.768	2.640.000
Shkalle në %	66%	73%	78%	80%	71%
Norma e mbulesës së punës	1.12	1.16	1.23	1.21	1.08

Viti 2014, inkasimi në euro.....**2.239.383** €,

Viti 2015, inkasimi në euro.....**2.507.335** €,


Viti 2016, inkasimi në euro.....**2.764.127** €,

Viti 2017, inkasimi në euro.....**2.912.768** €

Gjatë vitit 2017, inkasimi/arkëtimi është realizuar 111% e asaj që është planifikuar, shprehur në vlerë 272.768 € me shumë.

(Kemi një rritje konstante dhe stabile të inkasimit)

Faturimi:



Norma e mbulesës së punës gjatë viteve 2013 - 2016:

2014.....(1.12),

2015.....(1.16),

2016.....(1.23),

2017.....(1.21).

Në të Gjitha vitet kemi siguruar qëndrueshmëri.

(Ky është raporti në mes hyrave dhe shpenzimeve).

Humbjet ujit gjatë viteve:

Viti 2014.....71%,

Viti 2015.....66%,

Viti 2016.....65%,

Viti 2017.....62%.

o ***Një pasqyre e të priturve për vitin 2018.***

Gjatë vitit 2018, është planifikuar që shkalla e Arkëtimit të jetë si në tabelën e më poshtme.

Aktiviteti	Viti 2017	Planifikuar Viti 2018
Faturimi (€)	3.644.856	4.080.000
Inkasimet (€)	2.912.768	3.120.000
Shkalle në %	80%	76%
Norma mbulesës së punës	1.21	1.14
Uji i Pa faturuar %	62%	59%

• **Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten**

o ***Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit***

Gjatë vitit 2017 nuk kemi pasur dhe as nuk kemi iniciuar ndonjë marrëveshje me institucionet financiare për huazim ose tërheqje të kredisë.

o ***Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2017***

1. Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në fshatrat të cilat nuk janë në ombrellën e Hidrodrinit. Kemi Lugun e Baranit, si projekt i ri i cili ka 16 fshatra. Projekti nuk ka përfunduar ashtu që është në vazhdimësi edhe në vitin 2018. (Kjo është faza e parë e cila është donacion nga Zyra Zvicerane, faza e dytë do të fillojë pasi që të bëhet përfundimi i rrjetit ku do të bëhet kyqja në burim, ku Hidrodrini dhe KK-Pejë do të investohet me bashkëfinancim)
2. Projekti i rehabilitimit të fshatrave të cilat kanë furnizim, por nuk janë nën ombrellën e Hidrodrinit siç janë: Jabllanica e Vogël, Raushiqi, rajoni i Vokshit,

Doberdol, Glarev, Zabergj, Rigjevë, Mojstir, Sine ka filluar te implementohet gjate vitit 2017 dhe ende është ne vazhdimësi edhe në vitin 2018.

3. Rehabilitim I kulmit të ndërtesës se Hidrodrinit ne Deçan.
4. Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit ne fshatin Strellc ka filluar gjate viti 2017, I cili do te jete ne vazhdimë edhe ne vitin 2018.
5. Projekti me bashkëfinancim me KK-Pejë, për zgjerimin e rrjetit te kanalizimit i përfunduar.
6. Rehabilitim I sistemit të rrjetit te Ujësjellësit në Klinë i përfunduar.

o **Dividendët e paguara gjatë vitit 2017**

Meqenëse Kompania e Hidrodrinit ka një fitim prej 26.964 euro, nuk është kërkuar të paguaj dividend nga aksionari.

• **Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv**

o **Bordi I Drejtorëve në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë ka këtë përbërje**

1. z. Burim Basha -ing. i dipl.i makinerisë, kryetar-dt. emërimit 24.10.2015
2. z Musë Mushkolaj-ing. i dipl.i bujqësisë, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
3. z Esad Abdullahi- IDA, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
4. z Skënder Veseli-ing. i makinerisë, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
5. z Rasim Mahmutoviq-ing. i dipl. i elektrotek, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
6. z Sokol Boqolli-ecc. i dipl,anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
7. z.Agron Tigani-ing.i dipl. i ndërt. (hidroteknik), Kryeshef Ekzekutiv

o **Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017**

z Burim Basha	- kryesues8.100 €
z Musë Mushkolaj	- anëtar6.720 €
z Esad Abdullahi	- anëtar5.760 €
z Skënder Veseli	- anëtar6.200 €
z Rasim Mahmutoviq	- anëtar5.760 €
z Sokol Boqolli	- anëtar8.080 €

o **Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2017.**

KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë				
1	E rregullt	01.02.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
2	E rregullt	01.03.2017	13,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani, znsh.Filloreta Gashi si dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	29.03.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
4	E rregullt	28.04.2017	14,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	30.05.2017	11,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
6	MPVA	14.06.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani, znsh.Filloreta Gashi, znj.Arbërore Berinca dhe të ftuar tjerë
7	E rregullt	03.07.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
8	E rregullt	31.07.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani i dhe të ftuar tjerë
9	E rregullt	15.09.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	29.09.2017	10,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
11	E rregullt	31.10.2017	10,00	z. B. Basha, z. S. Boqolli, z.E. Abdullahi, z.R. Mahmutoviq, z.S. Veseli, z.M. Mushkolaj, z.A.Tigani, si dhe të ftuar tjerë.
12	E rregullt	04.12.2017	10,00	z.B.Basha, z.S. Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani, znjsh.Filloreta Gashi, dhe të ftuar tjerë.
13	E rregullt	29.12.2017	10,00	z.Burim.Basha, z.Sokol Boqolli, z.Esat Abdullahi, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, z.Agron Tigani dhe të ftuar tjerë

1	E jashtëzakonshme	06.03.2017	15,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
2	E jashtëzakonshme	18.04.2017	15,00	z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë

Bordi i Drejtorëve i KRU " Hidrodrini " Sh. A. Pejë gjatë vitit 2017 ka mbajtur 12(dymbëdhjetë) mbledhje të rregullta, 2(dy) të jashtëzakonshme si dhe Mbledhjen e

Përgjithëshme Vjetore të Aksionarit. I njëjti gjatë vitit 2017 ka operuar si një Bord unik dhe vendimet e marrura gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marruna me konsensus.

o Komisioni I Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:

1. Sokol Boqolli kryesues..... dt. emërimit 23.11.2015
2. Skënder Veseli..... anëtar..... dt. emërimit 23.11.2015
3. Musë Mushkolaj..... anëtar dt. emërimit 23.11.2015

Mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit të mbajtura gjatë vitit 2017:

Nr:	Mbledhjet e Komisionit të Auditimit	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	25.01.2017	11,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
2	E rregullt	24.02.2017	10,30	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	23.03.2017	10,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
4	E rregullt	25.04.2017	10,30	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	26.05.2017	14,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli dhe të ftuar tjerë
6	E rregullt	23.06.2017	14,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
7	E rregullt	25.07.2017	13,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
8	E rregullt	08.09.2017	14,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli dhe të ftuar tjerë
9	E rregullt	26.09.2017	10,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	25.10.2017	10,30	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
11	E rregullt	23.11.2017	11,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë
12	E rregullt	26.12.2017	10,00	z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe të ftuar tjerë

- **Informacione te tjera**

- ***Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2017***

KRU "Hidrodrini" Sh. A.- Pejë, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa të tilla.

- ***Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve***

Informata për aksionarin:

- **Informacione lidhur me Asetet e Kompanisë:**

Në vitin 2016 vlera e asetëve është 32.825.447€, kurse në vitin 2017 është 34.504.941€

Numri I punëtorëve gjatë viteve nuk ka ndryshuar, caku I menaxhmentit është që stafi të trajnohet ashtu që të rritet efikasiteti në punë.

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2014..... **5.30,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2015..... **5.00,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2016..... **4.73,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2017..... **4.50.**

(Es - është raporti i numrit të punëtorëve me konsumatorë, 1/1000)

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

• Ngjarjet kryesore të vitit 2017

Janar – Mars 2017 - TM1

- Raportin Operativ dhe Financiar për Dhjetor dhe TM4 – 2016 .
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për Dhjetor dhe TM4 – 2016.
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM 4 – 2016.
- Raportin Operativ dhe Financiar I KRU “ Hidrodrini” Sh. A. për Janar dhe Shkurt – 2017.
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për Janar dhe Shkurt – 2017.
- Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. për vitin 2016.
- Raporti Vjetor i performances të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2016
- Raporti Vjetor i Kënaqshmërisë së Konsumatorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2016.
- Këkesa Nr.prot.4 të dt.27.02.2017 e parashtruar nga ZLF dhe lejohet provizionimi I borgjeve të këqija .
- Vazhdimin e Kontratave për Zyrtarët e Lartë të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë edhe për një mandat.
- Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KRU “ Hidrodrini Sh. A. do të mbahen çdo muaj duke caktuar një termin nga dt. 25 – 28 të muajit gjegjës.
- Mbledhjet e Komisionit të Auditimit të mbahen çdo muaj duke caktuar një termin nga dt. 20 - 23 të muajit gjegjës.

Prill – Qershor 2017 – TM2

- Raportin Operativ dhe Financiar për Mars dhe TM1 – 2017 (Nr.prot 20/01/04/2017 i dt.28.04.2017.
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për TM1 – 2017 (Nr.prot.20/02/04/2017 dt.28.04.2017).
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM 1 – 2017 (Nr.prot.20/03/04.2017 dt. 28.04.2017).
- Raportin Operativ dhe Financiar I KRU “ Hidrodrini” Sh. A. për Prill – 2017 (Nr.prot.23/01/05/2017 dt.30.05.2017 dhe Maj- 2017 (Nr.prot.28/01/06/2017

dt.03.07.2017).

- Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare – 2016 dhe Letër Menaxhmentin Nr.20/04/04/2017 dt.28.04.2017.
- Konstatimin që Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2016 ka operuar si një Bord unik dhe se vendimet e marra gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marra me konsensus, me vota unanime. Nr.prot.(23/02/05/2017 dt. 30.05.2017).
- Vlerësimin e Performancës së KRU “ Hidrodrini” Sh.A. për vitin 2016 (Nr.prot.398 dt.30.05.2017).
- Rregulloret e hartuara nga ana e Autoritetit Rregullativ i Shërbimeve të Ujësjellësit (Nr.prot.23/03/05/2017 dt.30.05.2017).

Korrik – Shtator 2017 – TM3

- Raportin Operativ dhe Financiar për Qershor dhe TM2 – 2017 . (Vendimi nr.prot. 31/01/07/2017 të dt.31.07.2017.
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për Qershor dhe TM2 – 2017(Vendimi nr.prot.31/02/07/2017 të dt.31.07.2017.
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM 2 – 2017 (Vendimi nr.prot.31/03/07/2017 të dt.31.07.2017.
- Që Plani i Biznesit për vitin 2017 i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. të mbetet sipas parametrave të planifikuara dhe se rishikimi i tyre është i panevojshëm Me propozimin e menaxhmentit, Bordi i Drejtorëve do të merr vendim për ridestininim të mjeteve në suaza të planifikimit. (Vendimi nr.prot.31/04/07/2017 të dt.31.07.2017).
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë, për vitin 2016.(Vendimi nr.prot.31/05/07/2017 të dt.31.07.2017).
- Që janë plotësuar kushtet për ekzekutimin e Deklaratës për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë për vitin 2016 (vendimi nr.prot.31/06/07/2017 dt.31.07.2017).
- I. Aplikacioni i tarifave të shërbimit për furnizim me ujë dhe shërbimeve me ujëra të ndotura pranë Autoritetit Rregullativ për shërbimet e ujit për procesin tarifar 2018 - 2020. II. Autorizohet Menaxhmenti i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë që të aplikoj pranë Autoritetit Rregullativ për shërbimet e ujit, për tarifa të shërbimit për ujë dhe kanalizim në procesin rregullator 2018 – 202 (Vendimi nr.prot.31/07/07/2017 të dt.31.07.2017).
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. për Korrik -2017 (Vendimi nr.prot.37/01/08/2017 dt.15.09.2017).

- Aprovohet Kërkesa e menaxhmentit për të filluar procedurat për sigurimin shëndetësor vullnetar të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë.
- Për shpenzimet e pagesës së sigurimit shëndetësor vullnetar ngarkohet 50% KRU “ Hidrodrini” Sh. A. dhe 50% vet punëtori nga të ardhurat e tij.
- Maksimumi i tarifës të jet 20,00 €.
- Punëtorëve të ju mundësohet edhe sigurimi shëndetësor i anëtarëve të familjesme kushte të njëjta por pagesa për shpenzimet e sigurimit shëndetësor vullnetar për anëtarin e familjes , është obligim i punëtorit 100% (Vendiminr.prot.37/02/08/2017 të dt.15.09.2017).
- Raporti Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Gusht – 2017, me sugjerimet e dhëna (Vendimi nr.40/01/09/2017 të dt.29.09.2017).

Tetor– Dhjetor 2017 – TM4

- Raportin Operativ dhe Financiar I KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë për Shtator dhe TM 3 – 2017 . (Vendimi nr.prot 43/02/10/2017).
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. për Shtator dhe TM3 – 2017, (Vendimi nr.prot 43/02/10/2017).
- Raportin mbi Kënaqshmerinë e Konsumatorëve i KRU “ Hidrodrini ” Sh. A. për TM3 – 2017 . (Vendimi nr.prot.43/03/10/2017 dt.31.10.2017).
- Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor i KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për periudhën 2018 – 2020 . (Vendimi Nr.prot.43/04/10/2017 dt.31.10.2017)
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për muajin Tetor – 2017. (Vendimi nr.prot.47/01/11/2017 dt.04.12.2017).
- Obligimin e punëtorëve e KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë që t'i respektojnë dispozitat e Ligjit Nr.04/L-156 për kontrollin e duhanit të dt.04.04.2013 (Vendimi nr.prot.47/02/11/2017 dt.04.12.2017).
- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për muajin Nëntor – 2017. (Vendimi Nr.prot. 51/01/12/2017 dt.29. 12. 2017).
- Kërkesën Nr.prot.1063 të dt.26.12.2017 e parashtruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Vitit të Ri, të gjithë punëtorët të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 100 €për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen bashkë me pagën e muajit Dhjetor - 2017.(Vendimi Nr.prot.51/02/12/2017 dt.29.12.2017).

• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances

○ *Prodhimi i ujit*

KRU"Hidrodrini"Sh.A. - 2017			
Totali			
	Prodhimi mes. ditor	Prodhimi mujor	Prodhimi mesatar
	m ³	m ³	l/s
Janar	68,299	2,117,275	791
Shkurt	68,615	2,127,051	794
Mars	68,999	2,138,970	799
Prill	69,009	2,139,265	799
Maj	69,058	2,140,792	799
Qershor	69,257	2,146,979	802
Korrik	69,375	2,150,635	803
Gusht	69,469	2,153,541	804
Shtator	68,961	2,137,792	798
Tetor	68,774	2,132,006	796
Nëntor	68,805	2,132,944	796
Dhjetor	69,120	2,142,707	800
MES.	118,249	2,138,330	798

○ *Kualiteti i ujit*

Kualiteti i Ujitë - KRU"Hidrodrini"	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Totali i Testeve të realizuara	2.193	258	2.597	2.589
- Që nuk janë ne pajtim me standardet	29	4	0.16	0
- % (keq)	2%	1.5%	0%	0%

○ **Falja e Borxheve**

Njesia	Nr. I Konsumatorëve 2008	Saldo me 2008	Nr. I Konsumat. te falur nga borxhi 31.08.2017	Falja deri me 31.08.2017	% e realizuar
Peja	18,413	4,292,609	5,056	1,473,194	34.32
Istogu	7,606	994,937	3,370	487,510	49.00
Klina	3,586	376,964	2,009	208,914	55.42
Juniku	1,424	103,592	693	32,789	31.65
Deçani	4,889	557,337	2,993	328,257	58.90
Hidrodrini	35,918	6,325,439	13,908	2,452,528	38.77

○ **Ankesat te zgjedhura**

Treguesi	Aktiviteti	Totali
Ankesat Teknike te pranuar	Nr. Total	1.309
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	1.309
Ankesat komerciale te pranuar	Nr. Total	555
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	555

○ **Çështjet Ligjore**

Gjatë vitit 2017, në Shërbimin Juridik, të gjitha punët administrative janë kryer në mënyrë të rregullt.

Gjatë periudhës 2017 janë mbajtur 2 Seanca Gjyqësore në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë, për rastin e Paditësit Sylejmon Haxhaj NT "MODI" nga Klina me nr.Lëndë P.nr.407/2016. Objekt kontesti: Kompensim dëmi me vlerë prej 2.950€

Përfaqësuesi i KRU "Hidrodrini" duke u bazuar në mungesën e pjesmarrje në seance të palës paditëse si dhe duke e konsideruar padinë si të pa bazë, i kërkon Gjykatës ndërprerjen e procedurës konestimore në këtë çështje juridike.

Gjyqtari merr vendim: Aprovohet propozimi i palës së paditur.

Procedurat me Përmbartues Privat:

Lëndët me Marrëveshje -Pagesat - Debitorët nga Komuna e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës dhe Junikut:

Konsumatorë nga Nj.O Pejë.	Konsumatorë nga Nj.O Istog	Konsumatorë nga Nj.O Deçan	Konsumatorë nga Nj.O Klinë	Konsumatorë nga Nj.O Junik
75 lëndë me marrëveshje. Shuma totale 7098.81 €	16 lëndë me marrëveshje. Shuma totale 1755.21 €	369 lëndë me marrëveshje. Shuma totale 32800.36 €	4 lëndë me marrëveshje. Shuma totale 500.00 €	22 lëndë me marrëveshje. Shuma totale 4003.05 €
15 lëndet e përfunduara 9672.33 €	-----	16 lëndë të përfunduara 4823.79 €	-----	5 lëndet e përfunduara 2517.28 €

Shuma totale e inkasuar: 63 170.83 €

Lëndët me ndaljen e ½ së PENSIONIT ose PAGËS

Pagesat –Debitorët nga Komuna e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës dhe Junikut

Konsumatorë nga Nj.O Pejë.	Konsumatorë nga Nj.O Istog	Konsumatorë nga Nj.O Deçan	Konsumatorë nga Nj.O Klinë	Konsumatorë nga Nj.O Junik
0	2 raste shuma totale 155.00 €	23 raste shuma totale 1548.84€	0	5 raste shuma totale 806.08 €

Shuma totale e inkasuar: 2509.92 €

Shuma totale e inkasuar nga të gjitha lëndët në procedurë përmbarimore për vitin 2017, është shuma prej 65,680.75 €

Gjatë vitit 2017 kemi dërguar 197 Propozime për Përmbarim tek Përmbaruesi Privat.

- **Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet**

Nga Pasqyrat Financiare për vitet kemi:

Gjatë vitit 2014, fitimi prej 1.807 €,

Gjatë vitit 2015, fitimi prej 2.238 €,

Gjatë vitit 2016, fitimi prej 3.170 €,

Gjatë vitit 2017, fitim prej 26.964 €.

- **Progresi me planin e Biznesit**

Në tabelorin e mëposhtëm, është bërë krahasimi i vlerave të arritura gjatë viteve si dhe atyre të planifikuara për vitin 2017, janë indikatorët kyç të performances.

Raporti Operativ dhe Financiar – Performanca 2017

Company Name/Emri i Kompanise: HIDRODRINI, PEJE									
Year/Viti : 2017									
Month/Muaji: 12									
Closing Results from Previous Year									
Report on Key Performance Data and Indicators - January to June	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Half Year Results for 6-months		
Rezultatet Permbyllesë të Vitit të Kaluar									
Raporti mbi Te Dhenat dhe Treguesit Kryesor të Performances - Janar deri Qershor	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Half Year Results for 6-months		
	1	2	3	4	5	6			
D 001 Water Production (m3) / Uji i Prodhuar	25,563,723	2,117,275	2,127,051	2,138,970	2,139,265	2,140,792	2,146,979	12,810,332	
D 002 Water invoiced (m3) / Uji i faturuar	9,006,961	790,544	705,363	719,292	722,309	711,678	757,129	4,406,315	
D 0021 Uji I pa faturuar I kontrolluar(m3)	77,624	162,200	26,883	22,708	21,752	21,804	32,463	287,810	
D 003 Registered customers / Konsumatorët e regjistruar	45,196	45,266	45,386	45,985	46,363	46,575	47,258	47,258	
D 004 Number of bills issued / Nr. i faturave të lëshuara	41,483	43,079	43,133	43,060	43,017	43,354	43,807	43,807	
D 005 Customers billed by meter / Numri i kons. qe faturohen sipas leximit te ujematesave	40,650	39,900	40,096	40,122	40,460	40,853	41,387	41,387	
D 006 Water metered invoiced (m3) / Uji i faturuar per konsumatorët me ujematesa	8,810,161	774,534	689,060	703,431	706,513	695,803	741,064	4,310,405	
D 007 Value of bills (Eur) / Faturimi	€ 3,536,728	€ 265,834	€ 276,659	€ 288,661	€ 287,608	€ 290,372	€ 303,231	1,712,364	
D 008 Value of collections (Eur) / Inkasimi	€ 2,766,874	€ 165,962	€ 243,349	€ 246,788	€ 212,551	€ 235,806	€ 189,738	1,294,194	
D 009 Other operating income (Eur) / Të hyra të tjera operative	€ 43,293	€ 4,190	€ 5,407	€ 3,938	€ 11,481	€ 4,168	€ 3,836	33,020	
D 010 Operating costs (Eur) / Shpenzimet operative pa amortizim	€ 2,299,251	€ 191,682	€ 207,247	€ 224,039	€ 195,952	€ 198,014	€ 192,272	1,209,205	
